

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

të

"BARNATORJA POPULLORE" Gjilan

Emrat Alternativ/të mëhershëm dhe numrat e regjistrimeve:

BARNATORJA POPULLORE / NARODNA APOTEKA (Fi-617/78)

APOTEKARSKA USTANOVA (No Fi number)

Në bazë të nenit 39.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6, Organizimi i biznesit neni 9 i rregullores së UNMIK-ut 2002/12 (shtuar në rregulloren e UNMIK-ut 2005/18) në themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dhe nenin 43.3(d) të rregullores së UNMIK-ut 2005/48 në riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të tyre nën administrimin e autoritetit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, **NJOFTIMI I DHËNË KËTU për Likuidimin e ndërmarrjes së lartpërmendur fillon me efekt prej datës 16 Nëntor 2007**, në pajtim me vendimin e Bordit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit të datës 01 Nëntor 2007 sipas nenit 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.

Në Pajtim me Nenin 43.3 (d) dhe (e) Rregullores së UNMIK-ut Çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si kreditor, apo në lidhje me çfarëdo lloj aseti që ka të bëjë me ndërmarrjen, apo si pronar i ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër – **duhet të paraqesë Dëshmi për kërkesë rreth Likuidimit sa më shpejt që është e mundur, në adresat e poshtëshënuara para apo me 11 Prill 2008**. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë si rezultat ata persona nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të fituara nga likuidimi.

Formularët për Kërkesë rreth Likuidimit bashkangjitur me dëshmitë duhet dorëzuar në zyrat e AKM-së në:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

Zyra Regjionale Gjilan,

Baza e Logjistikës së UN-it, rruga e Bujanocit, 60000 Gjilan, Kosovë

TEL: +381 (0)38 504 604 EXT.7770; FAX: +381 (0)280 30 080

ose

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

Shtylla e IV-të e BE-së Zyra në Beograd, Tolstojeva 47-49, 11000 Beograd, Serbi.

TEL: +381 (0) 11 367 4006

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKM-së në adresën www.kta-kosovo.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih "Si të paraqitet kërkesa."

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në Zyren Regjionale në Gjilan, Baza e Logjistikës së UN-it - rruga e Bujanocit, do të jetë e hapur për inspektim publik në këtë zyrë pas datës 29 Prill 2008 (ose ndonjë date tjetër të bërë publike), deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye legjitime për pamundësinë e udhëtimit deri në adresën e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni të njëjtën adresë për të aranzhuar mënyrë tjetër të qasjes.

Asetet do të ofrohen për shitje nëpërmes tenderit me oferta të mbyllura në datën (jo me herët se 14 Mars 2008) që do të shpallet në të njëjtën mënyrë si ky njoftim dhe në Veb- faqet e AKM-së.